




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI



URDHËR

Nr. 63, datë 27.7.2021

PËR

**EMËRIMIN E KRYETARIT DHE TË ANËTARËVE TË BORDIT
TË AKREDITIMIT TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË
NË ARSIMIN E LARTË**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 6, të nenit 15, të ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të pikës 15, të vendimit nr.109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

URDHËROJ:

1. Emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Bordit të Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, si më poshtë vijon:

- | | |
|-------------------------|----------|
| a) Shqiponja Telhaj | kryetar; |
| b) Aleksandër Kohler | anëtar; |
| c) Aysen Savas | anëtar; |
| ç) Tomas Jelenski | anëtar; |
| d) Iraj Hashi | anëtar; |
| dh) Maurice Oudejans | anëtar; |
| e) Lea Ypi | anëtar; |
| ë) Kita Sallabanda Diaz | anëtar; |
| f) Darinka Piqani | anëtar; |
| g) Dritan Naçe | anëtar; |
| gj) Indrit Hoxha | anëtar. |

2. Mandati i kryetarit dhe i anëtarëve të Bordit të Akreditimit si dhe shpërblimi i tyre përcaktohen sipas parashikimeve të vendimit nr.109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, të ndryshuar.
3. Urdhri nr.32, datë 15.2.2017, i Kryeministrit, “Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Bordit të Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, shfuqizohet.
4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Bordi i Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

E D I R A M A



NR.PROT. 3611/1
DATË 4.7. 2021

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË
ARSIMIN E LARTË

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

